

LIGJ
Nr. 3/2023

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
NDËRKOMBËTARE TË HONG-KONGUT PËR RICIKLIMIN E SIGURT
DHE MJEDISOR TË ANIJEVE, 2009**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, bërë në maj të vitit 2009 në Hong-Kong, Kinë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 26.1.2023.

Shpallur me dekretin nr.22 datë 15.2.2023, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**KONVENTA NDËRKOMBËTARE E HONG-KONGUT PËR RICIKLIMIN E SIGURT
DHE MJEDISOR TË ANIJEVE, 2009**

Palët e kësaj konvente,

Duke theksuar shqetësimet në rritje për çështjet e sigurisë, shëndetit, mjedisit dhe mirëqenies në industrinë e riciklimin të anijeve,

Duke pranuar se riciklimi i anijeve kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe si i tillë, është alternativa më e mirë për anijet që nuk mund të funksionojnë më,

Bazuar në rezolutën A.962(23) të miratuar nga Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare Detare (udhëzime për riciklimin e anijeve); ndryshimet e udhëzimeve të miratuara me rezolutën A.980(24); vendimin VI/24 të Mbledhjes së Gjashtë të Konferencës së Palëve në Konventën e Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre, i cili miratoi udhëzimet teknike për administrimin e sigurt, për mjedisin, të çmontimit të plotë dhe të pjesshëm të anijeve dhe udhëzimet e miratuara nga sesioni i 289-të i organit drejtues të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (Siguria dhe Shëndeti gjatë Çmontimit të Anijeve: udhëzime për vendet aziatike dhe Turqinë),

Bazuar gjithashtu në rezolutën A.981(24), me të cilën Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare Detare i kërkoi Komitetit të Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të hartonte një dokument ligjor të zbatueshëm për riciklimin e anijeve,

Duke theksuar gjithashtu rolin e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve të angazhuar në riciklimin e anijeve,

Për më tepër, duke theksuar rolin e Konventës së Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit nga efektet negative që mund të rezultojnë si pasojë e këtyre mbetjeve,

Duke marrë parasysh qasjen paraprake të përcaktuar në parimin 15 të Deklaratës së Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, si edhe referuar vendimit MEPC.67(37), të miratuar nga Komiteti i Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar, më 15 shtator 1995,

Duke marrë parasysh gjithashtu nevojën për të promovuar zëvendësimin e materialeve të rrezikshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e anijeve me materiale më pak të rrezikshme ose mundësisht të parrezikshme, pa cenuar sigurinë e anijes, shëndetin e detarëve dhe efikasitetin funksional të anijes,

Vendosën të adresonin në mënyrë efektive, në një dokument ligjor të zbatueshëm, rreziqet mjedisore, rreziqet për sigurinë dhe shëndetin në punë në lidhje me riciklimin e anijeve, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të transportit detar dhe nevojën për të siguruar tërheqjen e anijeve që nuk mund të funksionojnë më,

Duke marrë në konsideratë se këto objektiva mund të përmbushen optimalisht me lidhjen e një Konvente Ndërkombëtare për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Detyrimet e përgjithshme

1. Secila palë e kësaj Konvente merr përsipër të zbatojë plotësisht dispozitat e saj, me qëllim që të parandalojë, reduktojë, minimizojë dhe në masën e mundur, të eliminojë aksidentet, lëndimet dhe efektet e tjera negative në shëndetin e njeriut dhe mjedis, të shkaktuara nga riciklimi i anijeve dhe të rrisë sigurinë e anijes, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit gjatë gjithë kohës së funksionimit të anijes.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do të interpretohet si pengesë për një Palë për marrjen, në mënyrë individuale ose të përbashkët, të masave më të rrepta në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, në lidhje me riciklimin e sigurt dhe mjedisor të anijeve, me qëllim parandalimin, reduktimin ose minimizimin e çdo efekti negativ mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

3. Palët do të përpiqen të bashkëpunojnë për implementimin, përputhshmërinë dhe zbatimin efektiv të kësaj Konvente.

4. Palët marrin përsipër të inkurajojnë zhvillimin e vazhdueshëm të teknologjive dhe praktikave që kontribuojnë në riciklimin e sigurt dhe mjedisor të anijeve.

5. Shtojca e kësaj Konvente është pjesë përbërëse e saj. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë në këtë Konventë përbën në të njëjtën kohë një referencë në shtojcën e saj.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe:

1. “Konventa” nënkupton Konventën Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009.

2. “Administrata” nënkupton qeverinë e shtetit, flamurin e të cilit anija ka të drejtë të mbajë ose shteti nën autoritetin e të cilit ajo funksionon.

3. “Autoriteti/et kompetente” nënkupton një autoritet qeveritar ose autoritete të përcaktuara nga një Palë si përgjegjëse, brenda zonës apo zonave gjeografike të caktuara të ekspertizës, për detyrat që lidhen me objektet e riciklimit të anijeve që operojnë brenda juridiksionit të asaj Pale, siç specifikohet në këtë Konventë.

4. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare.

5. “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

6. “Komiteti” nënkupton Komitetin e Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit Detar.

7. “Anije” nënkupton një anije të çfarëdo lloji që operon ose ka operuar në mjedisin detar dhe përfshin zhytësit, mjetet lundruese, platformat lundruese, platformat me vinç automatik, depozita lundruese (FSU) dhe pajisje lundruese të magazinimit dhe shkarkimit (FPSOs), duke përfshirë një anije pa pajisje ose të rimorkiuar.

8. “Tonazh bruto” nënkupton tonazhin bruto (GT) të llogaritur në përputhje me rregulloret e matjes së tonazhit të përfshira në shtojcën I të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, 1969 ose në ndonjë konventë pasuese.

9. “Material i rrezikshëm” nënkupton çdo material ose substancë që mund të përbëjë rrezik për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin.

10. “Riciklimi i anijes” nënkupton çmontimin e plotë ose të pjesshëm të një anijeje në një objekt për riciklimin e anijeve, me qëllim rikuperimin e komponentëve dhe materialeve për ripërpunim dhe ripërdorim, duke u kujdesur për materialet e rrezikshme dhe materiale të tjera dhe përfshin operacionet përkatëse si magazinimi dhe trajtimi i përbërësve dhe materialeve në vend, por jo përpunimin e mëtejshëm ose asgjësimin e tyre në objekte të veçanta.

11. “Objekti i riciklimit të anijeve” nënkupton një zonë të përcaktuar që është një shesh punimesh, kantier ose objekt i përdorur për riciklimin e anijeve.

12. “Shoqëria e riciklimit” nënkupton pronarin e objektit të riciklimit të anijeve ose çdo organizatë ose person që mban përgjegjësi për funksionimin e aktivitetit të riciklimit të anijes nga pronari i objektit të riciklimit të anijeve dhe i cili me marrjen e një përgjegjësie të tillë, ka rënë dakord të marrë përsipër të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e vendosura nga kjo Konventë.

Neni 3 Zbatimi

1. Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Konventë, kjo Konventë do të zbatohet, për:

- 1) anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e një Pale ose që operojnë nën autoritetin e saj;
- 2) Objektet e riciklimit të anijeve që operojnë nën juridiksionin e një Pale.

2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për asnjë anije luftarake, anije ndihmëse të flotës detare ose anije të tjera në pronësi ose në funksion të një Pale dhe të përdorura aktualisht vetëm për shërbime qeveritare jotregtare. Megjithatë, çdo Palë do të garantojë, duke miratuar masat e duhura që nuk dëmtojnë operacionet ose aftësitë funksionale të anijeve të tilla në pronësi ose në funksion të Palës, që anije të tilla të veprojnë në përputhje me këtë Konventë, në masën që është e arsyeshme dhe e zbatueshme.

3. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për anijet më pak se 500 GT (tonazh bruto) ose për anijet që operojnë vetëm në ujëra që i nënshtrohen sovranitetit ose juridiksionit të shtetit flamurin e të cilit anija ka të drejtë të mbajë. Megjithatë, çdo Palë do të garantojë, me miratimin e masave të duhura, që anije të tilla të veprojnë në përputhje me këtë Konventë, në masën që është e arsyeshme dhe e zbatueshme.

4. Në lidhje me anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e jopalëve të kësaj Konvente, Palët do të zbatojnë kërkesat e kësaj Konvente, siç mund të jetë e nevojshme për të siguruar që anijet e tilla të mos favorizohen.

Neni 4 Kontrollet në lidhje me riciklimin e anijeve

1. Çdo Palë duhet të kërkojë që anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e njëres prej tyre ose që janë në funksion të saj, të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Konventë dhe duhet të marrë masa efektive për ta siguruar këtë pajtueshmëri.

2. Çdo Palë duhet të kërkojë që objektet e riciklimit të anijeve që operojnë nën juridiksionin e saj të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Konventë dhe duhet të marrë masa efektive për ta siguruar këtë pajtueshmëri.

Neni 5 Inspektimi dhe certifikimi i anijeve

Çdo Palë duhet të sigurojë që anijet që mbajnë flamurin e njëres prej tyre ose janë në funksion të saj dhe që i nënshtrohen inspektimit dhe certifikimit, të inspektohen dhe certifikohen në përputhje me rregulloret në shtojcë.

Neni 6

Autorizimi i objekteve të riciklimit të anijeve

Çdo Palë duhet të garantojë që objektet e riciklimit të anijeve që operojnë nën juridiksionin e saj dhe që anijet e ricikluara për të cilat zbatohet kjo Konventë, ose anijet e trajtuara në mënyrë të ngjashme në përputhje me nenin 3.4 të kësaj Konvente, të autorizohen në përputhje me rregulloret në shtojcë.

Neni 7

Shkëmbimi i informacionit

Për objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë, kjo Palë do t'i sigurojë organizatës, nëse kërkohet, informacionin përkatës në lidhje me këtë Konventë mbi të cilin është bazuar vendimi i saj për autorizim, si dhe Palëve që mund ta kërkojnë atë. Informacioni duhet të shkëmbehet në mënyrë të shpejtë dhe në kohë.

Neni 8

Inspektimi i anijeve

1. Një anije për të cilën zbatohet kjo Konventë, në çdo port ose terminal në det të hapur të një Pale tjetër, mund t'i nënshtrohet inspektimit nga nëpunësit e autorizuar ligjrisht nga ajo Palë, me qëllim të përcaktimit nëse anija është në përputhje me këtë Konventë. Përveç siç parashikohet në paragrafin 2, çdo inspektim i tillë kufizohet në verifikimin që ka në bord një certifikatë ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme ose një certifikatë ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim, e cila, nëse është e vlefshme, do të pranohet.

2. Një inspektim i detajuar mund të kryhet duke marrë parasysh udhëzimet e dhëna nga Organizata kur një anije nuk ka një certifikatë të vlefshme ose ka arsye të qarta për të besuar se:

1. gjendja e anijes ose e pajisjeve të saj nuk korrespondon kryesisht me të dhënat e certifikatës dhe/ose pjesës I të inventarit të materialeve të rrezikshme; ose

2. nuk zbatohet asnjë procedurë në bordin e anijes për mirëmbajtjen e pjesës I të inventarit të materialeve të rrezikshme.

Neni 9

Zbulimi i shkeljeve

1. Palët do të bashkëpunojnë për zbulimin e shkeljeve dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

2. Kur ka prova të mjaftueshme që një anije funksionon, ka funksionuar ose është gati të funksionojë në kundërshtim me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, një Palë që ka prova mund të kërkojë hetimin e kësaj anijeje kur ajo hyn në portet ose терминаlet në det të hapur nën juridiksionin e një Pale tjetër. Raporti i një hetimi të tillë do t'i dërgohet Palës që e kërkon atë, administratës së anijes në fjalë dhe organizatës, në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme.

3. Nëse zbulohet se anija është në kundërshtim me Konventën, Pala që kryen inspektimin mund të marrë masa për të paralajmëruar, ndaluar, larguar ose përjashtuar anijen nga portet e saj. Një Palë që ndërmerr masa të tilla do të informojë menjëherë administratën e anijes në fjalë dhe organizatën.

4. Nëse ndonjë nga Palët merr kërkesë për hetim, së bashku me prova të mjaftueshme që një objekt i riciklimit të anijeve është duke funksionuar, ka funksionuar ose do të funksionojë në kundërshtim me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, Pala për të cilën funksionon objekti i riciklimit të anijeve duhet të hetojë operimin e këtij objekti riciklimi në funksion të saj dhe të përgatisë një raport. Raporti i çdo hetimi të tillë do t'i dërgohet Palës që e kërkon atë, duke përfshirë informacionin mbi masat e ndërmarra ose që do të ndërmerren, nëse ka, dhe Organizatës për masat e duhura.

Neni 10 Shkeljet

1. Çdo shkelje e kërkesave të kësaj Konvente do të ndalohet nga ligjet kombëtare dhe:

1) në rastin e një anijeje, sanksionet do të vendosen sipas ligjit të administratës, kudo ku ndodh shkelja. Nëse administrata informohet për një shkelje të tillë nga një Palë, ajo do të hetojë çështjen dhe mund t'i kërkojë Palës raportuese të japë prova shtesë për shkeljen e dyshuar. Nëse administrata është e bindur se ka prova të mjaftueshme për të mundësuar fillimin e procedimeve në lidhje me shkeljen e dyshuar, ajo do të garantojë që këto procedura të ndërmerren sa më shpejt që të jetë e mundur, në përputhje me ligjin e saj. Administrata do të informojë menjëherë Palën që ka denoncuar shkeljen e dyshuar, si dhe organizatën, për çdo veprim të ndërmarrë. Nëse administrata nuk ka marrë asnjë masë brenda një viti pas marrjes së informacionit, ajo do të informojë Palën që ka denoncuar shkeljen e dyshuar dhe organizatën për arsyet përse nuk është ndërmarrë asnjë masë;

2) në rastin e një objekti riciklimi të anijeve, sanksionet do të vendosen në bazë të ligjit të Palës që ka juridiksionin mbi objektin e riciklimit të anijeve. Nëse Pala informohet për shkelje nga një Palë tjetër, ajo do të hetojë çështjen dhe mund t'i kërkojë Palës denoncuese të japë prova shtesë për shkeljen e dyshuar. Nëse Pala është e bindur se ka prova të mjaftueshme për të mundësuar fillimin e procedimeve në lidhje me shkeljen e dyshuar, ajo do të garantojë që këto procedura të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me ligjin e saj. Pala do të informojë menjëherë Palën që ka denoncuar shkeljen e dyshuar, si dhe organizatën, për çdo veprim të ndërmarrë. Nëse Pala nuk ka ndërmarrë asnjë masë brenda një viti pas marrjes së informacionit, ajo do të informojë Palën që ka denoncuar shkeljen e dyshuar dhe organizatën për arsyet përse nuk është ndërmarrë asnjë masë.

2. Çdo shkelje e kërkesave të kësaj Konvente brenda juridiksionit të çdo Pale do të ndalohet dhe sanksionet do të vendosen sipas ligjeve të asaj Pale. Kurdoherë që ndodh një shkelje e tillë, ajo Palë:

1) duhet të garantojë që procedimet të kryhen në përputhje me ligjin e saj; ose

2) t'i japë administratës së anijes informacionin dhe provat që mund të ketë në zotërim për shkeljen.

3. Sanksionet e parashikuara nga ligjet e një Pale në përputhje me këtë nen do të jenë në shkallë sa më të përshtatshme për të shkurajuar shkeljet e kësaj Konvente, kudo që ndodhin.

Neni 11 Vonesa ose ndalimi i panevojshëm i anijeve

1. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur ndalimin ose vonesën e panevojshme të një anijeje sipas neneve 8, 9 ose 10 të kësaj Konvente.

2. Kur një anije ndalohet ose vonohet në mënyrë të panevojshme sipas neneve 8, 9 ose 10 të kësaj Konvente, ajo do të ketë të drejtën e dëmshpërblimit për çdo humbje ose dëmtim të pësuar.

Neni 12 Komunikimi i informacionit

Çdo Palë do t'i raportojë organizatës dhe organizata duhet të shpërndajë, sipas rastit, informacionin e mëposhtëm:

1. një listë të objekteve të riciklimit të anijeve të autorizuara në përputhje me këtë Konventë dhe që operojnë nën juridiksionin e asaj Pale;

2. detajet e kontaktit për autoritetin/et kompetent, duke përfshirë një pikë të vetme kontakti, për atë Palë;

3. një listë të organizatave të njohura dhe gjeodetëve të emëruar të cilët janë të autorizuar të veprojnë në emër të asaj Pale për administrimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e riciklimit të anijeve në përputhje me këtë Konventë, si dhe përgjegjësitë dhe kushtet specifike të autoritetit të deleguar tek organizatat e njohura ose gjeodetët e emëruar;

4. një listë vjetore të anijeve që mbajnë flamurin e asaj Pale, së cilës i është lëshuar një certifikatë ndërkombëtare e gatishmërisë për riciklim, duke përfshirë emrin e Shoqërisë së Riciklimit dhe vendndodhjen e objektit të riciklimit të anijeve siç specifikohet në certifikatë;

5. një listë vjetore të anijeve të ricikluara brenda juridiksionit të asaj Pale;

6. informacion në lidhje me shkeljet e kësaj Konvente; dhe

7. veprimet e ndërmarra ndaj anijeve dhe objekteve të riciklimit të anijeve nën juridiksionin e asaj Pale.

Neni 13

Asistenca teknike dhe bashkëpunimi

1. Palët marrin përsipër, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatës dhe organeve të tjera ndërkombëtare, sipas rastit, të ofrojnë mbështetje për ato Palë që kërkojnë asistencë teknike në lidhje me riciklimin e sigurt dhe mjedisor të anijeve:

1) për të trajnuar personelin;

2) për të garantuar disponueshmërinë e teknologjisë përkatëse, pajisjeve dhe objekteve;

3) për të filluar programe të përbashkëta zhvillimi dhe kërkimore; dhe

4) për të ndërmarrë veprime të tjera që synojnë zbatimin efektiv të kësaj Konvente dhe të udhëzimeve të hartuara nga organizata në lidhje me të.

2. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë në mënyrë aktive, duke iu nënshtuar ligjeve, rregulloreve dhe politikave të tyre kombëtare, për transferimin e sistemeve të menaxhimit dhe teknologjisë në lidhje me riciklimin e sigurt dhe mjedisor të anijeve.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente me marrëveshje ose nëpërmjet mënyrave të tjera paqësore të caktuara prej tyre, si hetimi, ndërmjetësimi, pajtimi, arbitrazhi, zgjidhja gjyqësore ose duke u drejtuar tek agjencitë ose masat rajonale.

Neni 15

Marrëdhënia me të drejtën ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

1. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e ndonjë shteti sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtën e detit", 1982 dhe sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare të detit.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare përkatëse dhe të zbatueshme.

Neni 16

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga çdo shtet në selinë e organizatës nga 1 shtatori 2009 deri më 31 gusht 2010 dhe më pas do të mbetet e hapur për aderim nga çdo shtet.

2. Shtetet mund të bëhen palë në këtë Konventë nëpërmjet:

1) nënshkrimit që nuk i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit; ose

2) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, i pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

3) aderimit.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të kryhet me paraqitjen e një dokumenti ligjor te Sekretari i Përgjithshëm.

4. Nëse një shtet përbëhet nga dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat sisteme të ndryshme të ligjit janë të zbatueshme në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë në

momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit se kjo Konventë do të shtrihet për të gjitha njësitë e tij territoriale, vetëm për një ose më shumë prej tyre dhe mund të bëjë ndryshime në këtë deklaratë duke paraqitur një deklaratë tjetër në çdo kohë.

5. Një deklaratë sipas paragrafit 4, do t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm me shkrim dhe në të do të përcaktohet shprehimisht njëzia ose njësitë territoriale për të cilat zbatohet kjo Konventë.

6. Një shtet, në momentin kur shpreh pëlqimin për t'u lidhur ligjërisht me Konventën, do të deklarojë nëse kërkon miratim të qartë ose të heshtur të Planit të Riciklimit të Anijeve përpara se një anije të mund të riciklohet në objektin/et e autorizuar të riciklimit të anijeve. Kjo deklaratë mund të rishikohet më pas me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Një rishikim i tillë do të specifikojë datën efektive të rishikimit.

Neni 17 Zbatueshmëria

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi 24 muaj pas datës kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

1) jo më pak se 15 shtete e kanë nënshkruar atë pa rezervë për sa i përket ratifikimit, pranimit ose miratimit ose kanë paraqitur dokumentin ligjor të nevojshëm të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në përputhje me nenin 16;

2) flotat e kombinuara tregtare të Shteteve të përmendura në paragrafin 1.1 përbëjnë jo më pak se 40 për qind të tonazhit bruto të transportit tregtar në botë; dhe

3) vëllimi maksimal vjetor i kombinuar i riciklimit të anijeve të shteteve të përmendura në paragrafin 1.1 gjatë 10 vjetëve të mëparshëm përbën jo më pak se 3 për qind të tonazhit bruto të transportit të kombinuar tregtar të të njëjtave shtete.

2. Për shtetet që kanë paraqitur një dokument ligjor ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi në lidhje me këtë Konventë pasi janë përmbushur kërkesat për hyrjen në fuqi të saj, por përpara datës së hyrjes në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, ose tre muaj pas datës së paraqitjes së dokumentit ligjor, cilado qoftë data e mëvonshme.

3. Çdo dokument ligjor ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i paraqitur pas datës kur kjo Konventë hyn në fuqi, do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së paraqitjes.

4. Pas datës kur një ndryshim i kësaj Konvente konsiderohet se është pranuar sipas nenit 18, çdo dokument ligjor ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i paraqitur do të zbatohet për Konventën, i ndryshuar.

Neni 18 Ndryshimet

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet me secilën nga procedurat e specifikuar në paragrafët e mëposhtëm.

2. Ndryshimet pas shqyrtimit brenda organizatës:

1) çdo Palë mund të propozojë një ndryshim të kësaj Konvente. Një ndryshim i propozuar do t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm, i cili më pas do ta transmetojë atë te Palët dhe anëtarët e organizatës të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tij;

2) një ndryshim i propozuar dhe i përcjellë si më sipër i referohet Komisionit për shqyrtim. Palët, qofshin ose joanëtare të organizatës, do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e Komitetit për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit.

3) ndryshimet do të miratohen me një shumicë prej dy të tretave të Palëve të pranishme që votojnë në Komitet, me kusht që të paktën një e treta e Palëve të jenë të pranishme në kohën e votimit.

4) ndryshimet e miratuara në përputhje me nënparagrafin 3 do t'u komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm Palëve për pranim.

5) një ndryshim do të konsiderohet i pranuar në rrethanat e mëposhtme:

5.1) një ndryshim i një neni të kësaj Konvente do të konsiderohet i pranuar në datën kur dy të tretat e Palëve kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij;

5.2) Një ndryshim i shtojcës do të konsiderohet i pranuar në fund të një periudhe që do të përcaktohet nga Komiteti në kohën e miratimit të tij, periudhë e cila nuk do të jetë më pak se dhjetë muaj pas datës së miratimit. Megjithatë, nëse deri në atë datë më shumë se një e treta e Palëve njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm se e kundërshtojnë ndryshimin, ai nuk do të konsiderohet i pranuar.

6) Një ndryshim hyn në fuqi në kushtet e mëposhtme:

6.1) Një ndryshim i një neni të kësaj Konvente do të hyjë në fuqi, për ato Palë që kanë deklaruar se e kanë pranuar atë, gjashtë muaj pas datës kur ai konsiderohet i pranuar në përputhje me nënparagrafin 5.1;

6.2) Një ndryshim i shtojcës do të hyjë në fuqi në lidhje me të gjitha Palët gjashtë muaj pas datës kur ai konsiderohet i pranuar, me përjashtim të çdo Pale, që:

6.2.1) ka njoftuar për kundërshtimin e saj ndaj ndryshimit në përputhje me nënparagrafin .5.2 dhe që nuk e ka tërhequr këtë kundërshtim; ose

6.2.2) ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm, përpara hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi, se ai do të hyjë në fuqi vetëm pas një njoftimi të mëvonshëm për pranimin e tij;

6.3) Një Palë që ka njoftuar një kundërshtim sipas nënparagrafit .6.2.1, mund të njoftojë më pas Sekretarin e Përgjithshëm që e pranon ndryshimin. Një ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi për këtë Palë gjashtë muaj pas datës së njoftimit të pranimit ose datës kur amendamenti hyn në fuqi, cilado qoftë data e mëvonshme;

6.4) nëse një Palë që ka bërë një njoftim të përmendur në nënparagrafin .6.2.2 njofton Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tij në lidhje me një ndryshim, ky ndryshim do të hyjë në fuqi për këtë Palë gjashtë muaj pas datës së njoftimit të pranimit ose datës kur ndryshimi hyn në fuqi, cilado qoftë data e mëvonshme.

3. Amendamenti nëpërmjet një konference:

1) Me kërkesën e një Pale të miratuar nga të paktën një e treta e Palëve, organizata do të zhvillojë një konferencë të Palëve për të shqyrtuar ndryshimet e kësaj Konvente;

2) Një ndryshim i miratuar nga një konferencë e tillë me shumicë prej dy të tretave të Palëve të pranishme që votojnë, do t'u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Palëve për pranim;

3) Nëse në Konferencë nuk vendoset ndryshe, ndryshimi do të konsiderohet i pranuar dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara përkatësisht në paragrafët 2.5 dhe 2.6;

4) Çdo Palë që refuzon të pranojë një ndryshim të shtojcës do të trajtohet sikur nuk është Palë vetëm për qëllimin e zbatimit të atij ndryshimi;

5) Çdo njoftim sipas këtij neni do t'i bëhet me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm;

6) Sekretari i Përgjithshëm do të informojë Palët dhe anëtarët e organizatës, për:

1) çdo ndryshim që hyn në fuqi dhe datën e hyrjes së tij në fuqi, përgjithësisht, si dhe për secilën Palë; dhe

2) çdo njoftim të bërë sipas këtij neni.

Neni 19

Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga çdo Palë në çdo kohë pas përfundimit të dy viteve nga data kur kjo Konventë hyn në fuqi për atë Palë.

2. Denoncimi do të kryhet me njoftim me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, për të hyrë në fuqi një vit pas marrjes ose një periudhë më të gjatë siç mund të specifikohet në atë njoftim.

Neni 20

Depozitari

1. Kjo Konventë do të ruhet pranë Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'u transmetojë kopje të certifikuara të kësaj Konvente të gjitha shteteve që kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë aderuar në të.

2. Përveç funksioneve të specifikuara diku tjetër në këtë Konventë, Sekretari i Përgjithshëm do të:

1) informojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë aderuar në të, për:

- 1.1) çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një dokumenti ligjor ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;
 - 1.2) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;
 - 1.3) depozitim të çdo dokumenti ligjor denoncimi nga kjo Konventë, së bashku me datën kur është marrë dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi; dhe
 - 1.4) deklaratat dhe njoftime të tjera të marra në përputhje me këtë Konventë; dhe
- 2) sapo kjo Konventë të hyjë në fuqi, t'ia dërgojë tekstin e saj Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, për regjistrim dhe botim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 21 Gjuhët

Kjo Konventë është hartuar në një kopje të vetme origjinale në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëloj autentik.

Hartuar në Hong-Kong, Kinë, më 15 maj 2019.

Në dëshmi të sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë ligjërish të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

SHTOJCË RREGULLORE PËR RICIKLIMIN E SIGURT DHE MJEDISOR TË ANIJEVE KAPITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Rregullorja 1 - Përkuftizime

Për qëllime të kësaj shtojçe:

1. "Person kompetent" nënkupton personin me kualifikime, trajnime dhe njohuri të mjaftueshme, përvojë dhe aftësi për kryerjen e një pune specifike. Në mënyrë të veçantë, një person kompetent mund të jetë një punëtor i trajnuar ose punonjës menaxherial i aftë për të njohur dhe vlerësuar rreziqet profesionale, rreziqet dhe ekspozimin e punonjësve ndaj materialeve potencialisht të rrezikshme ose kushteve të pasigurta në një objekt riciklimi të anijes dhe i cili është në gjendje të specifikojë mbrojtjen e nevojshme dhe masat paraprake që duhen marrë për të eliminuar ose zvogëluar ato rreziqe ose ekspozime. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë kriteret e duhura për caktimin e këtyre personave dhe mund të përcaktojë detyrat që do t'u ngarkohen atyre.

2. "Punëdhënës" nënkupton një person fizik ose juridik që punëson një ose më shumë punëtorë të angazhuar në riciklimin e anijeve.

3. "Anije ekzistuese" nënkupton një anije që nuk është anije e re.

4. "Anije e re" nënkupton një anije:

- 1) për të cilën kontrata e ndërtimit është lidhur në ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente; ose
- 2) në mungesë të një kontrate ndërtimi, trupi i anijes është shtruar ose anija është në një fazë të ngjashme ndërtimi në ose pas gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente; ose
- 3) dorëzimi i të cilave kryhet në ose pas 30 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

5. "Instalim i ri" nënkupton instalimin e sistemeve, pajisjeve, izolimit ose materialeve të tjera në një anije pas datës kur kjo Konventë hyn në fuqi.

6. "E sigurt për hyrje" nënkupton një hapësirë që plotëson kriteret e mëposhtme:

- 1) Përmbajtja e oksigjenit në atmosferë dhe përqendrimi i avujve të ndezshëm janë brenda kufijve të sigurt;
- 2) çdo material toksik në atmosferë është brenda përqendrimeve të lejuara; dhe
- 3) çdo mbetje ose material që lidhet me punën e autorizuar nga personi kompetent nuk do të prodhojë çlirim të pakontrolluar të materialeve toksike ose një përqendrim të pasigurt të avujve të ndezshëm në kushtet ekzistuese atmosferike, ndërsa mbahen sipas udhëzimeve.

7 "Siguria në punë që lidhet me nxehësinë" nënkupton një hapësirë që plotëson kriteret e mëposhtme:

1) ekziston një gjendje e sigurt, joshpërthyesë, duke përfshirë statusin pa gaz, për përdorimin e pajisjeve të saldimit me hark elektrik ose me gaz, pajisje prerëse ose djegëse ose forma të tjera të flakës së ekspozuar, si dhe ngrohje, bluarje ose operacione të gjenerimit të shkëndijave;

2) Kërkesat e sigurta për hyrje të rregullores 1.6 janë përmbushur,

3) kushtet ekzistuese atmosferike nuk do të ndryshojnë si rezultat i punës që lidhet me nxehtësinë, dhe

4) Të gjitha hapësirat ngjitur janë pastruar, ose inertuar ose trajtuar mjaftueshëm për të parandaluar fillimin ose përhapjen e zjarrit.

8. “Pronar i anijes” nënkupton personin ose personat ose shoqërinë e regjistruar si pronar i anijes ose, në mungesë të regjistrimit, personin ose personat ose shoqërinë që zotëron anijen ose çdo organizatë ose person tjetër si menaxheri ose qiradhënësi i anijes, i cili ka marrë përgjegjësinë për funksionimin e anijes nga pronari i saj. Megjithatë, në rastin e një anijeje në pronësi të një shteti dhe që operohet nga një shoqëri e cila në atë shtet është e regjistruar si operatori i anijes, atëherë një shoqëri e tillë do të nënkuptojë “pronarin”.

Ky term përfshin gjithashtu ata që kanë pronësinë e anijes për një periudhë të kufizuar në pritje të shitjes së saj ose dorëzimit në një objekt riciklimi të anijes.

9. “Inspektim në terren” nënkupton një inspektim të objektit të riciklimit të anijes që konfirmon gjendjen e përshkruar në dokumentacionin e verifikuar.

10. “Deklarata e përfundimit” nënkupton një deklaratë konfirmuese të lëshuar nga objekti i riciklimit të anijeve që riciklimi i anijes ka përfunduar në përputhje me këtë Konventë.

11. “Cisternë” nënkupton një cisternë naftë siç përcaktohet në shtojcën I të MARPOL-it ose një cisternë NLS siç përcaktohet në shtojcën II të MARPOL-it.

12. “Punëtor” nënkupton çdo person që kryen punë, rregullisht ose përkohësisht, në kontekstin e një marrëdhënieje pune, duke përfshirë personelin kontraktues.

Rregullorja 2 - Zbatueshmëria e përgjithshme

Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, projektimi, ndërtimi, inspektimi, certifikimi, operimi dhe riciklimi i anijeve do të kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj shtojce.

Rregullorja 3 - Marrëdhënia me standardet, rekomandimet dhe udhëzimet e tjera

Palët do të marrin masa për të zbatuar kërkesat e rregulloreve të kësaj shtojce, duke marrë parasysh standardet, rekomandimet dhe udhëzimet përkatëse dhe të zbatueshme, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës dhe standardet teknike përkatëse dhe të zbatueshme, rekomandimet dhe udhëzimet e hartuara sipas Konventës së Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre.

KAPITULLI 2 KËRKESAT PËR ANIJE

Pjesa A

Projektimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e anijeve

Rregullorja 4 - Kontrollat e materialeve të rrezikshme të anijeve

Në përputhje me kërkesat e specifikuara në shtojcën 1 të kësaj Konvente, secila Palë:

1. do të ndalojë dhe/ose kufizojë instalimin ose përdorimin e materialeve të rrezikshme të renditura në shtojcën 1 në anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e saj ose që veprojnë nën autoritetin e saj; dhe

2. do të ndalojë dhe/ose kufizojë instalimin ose përdorimin e materialeve të tilla në anije, ndërsa ndodhen në portet e saj, kantieret detare, kantieret e riparimit të anijeve ose терминаlet në det, dhe do të marrë masa efektive për të garantuar që anije të tilla të jenë në përputhje me këto kërkesa.

Rregullorja 5 - Inventari i materialeve të rrezikshme

1. Çdo anije e re do të ketë në bord një inventar të materialeve të rrezikshme. Inventari do të verifikohet ose nga administrata, ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj, duke marrë parasysh udhëzimet, përfshirë çdo vlerë pragu dhe përjashtime të përfshira në ato udhëzime, të

zhvilluara nga organizata. Inventari i materialeve të rrezikshme do të jetë specifik për secilën anije dhe duhet të paktën:

1) të identifikojë si pjesën I, materialet e rrezikshme të renditura në shtojcat 1 dhe 2 të kësaj Konvente dhe të përfshira në strukturën ose pajisjet e anijes, vendndodhjen e tyre dhe sasinë e përafërta; dhe

2) të sqarojë se anija është në përputhje me rregulloren 4.

2. Anijet ekzistuese do të jenë në përputhje, në masën që është e mundur, me paragrafin 1 jo më vonë se 5 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, ose përpara se të shkojnë për riciklim nëse kjo është më herët, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga Organizata dhe Sistemi i Harmonizuar i Organizatës i Inspektimit dhe Certifikimit. Materialet e rrezikshme të listuara në shtojcën 1 do të identifikohen kur të përgatitet inventari. Për anijet ekzistuese do të përgatitet një plan që përshkruan kontrollin vizual të mostrave me të cilin zhvillohet inventari i materialeve të rrezikshme, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

3. Pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme do të mirëmbahet dhe përditësohet siç duhet gjatë gjithë funksionimit të anijes, duke pasqyruar instalimet e reja që përmbajnë materiale të rrezikshme të listuara në shtojcën 2 dhe ndryshimet përkatëse në strukturën dhe pajisjet e anijes, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

4. Përpara riciklimit, inventari, përveç pjesës I të mirëmbajtur dhe të përditësuar, do të përfshijë pjesën II për mbetjet e krijuara në mënyrë operacionale dhe pjesën III për depot, dhe do të verifikohet ose nga administrata ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

Rregullorja 6 - Procedura për propozimin e ndryshimeve në shtojcat 1 dhe 2

1. Çdo Palë mund të propozojë një ndryshim në shtojcën 1 dhe/ose shtojcën 2 në përputhje me këtë rregullore. Ndryshimi i propozuar do të shqyrtohet brenda organizatës sipas nenit 18, paragrafi 2 dhe kësaj rregulloreje.

2. Kur organizata merr një propozim, ajo gjithashtu do t'ia sjellë propozimin në vëmendje Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të saj të specializuara, organizatave ndërqeveritare që kanë marrëveshje me organizatën dhe organizatave joqeveritare në status konsultativ me organizatën dhe do ta vërë në dispozicion të tyre.

3. Komiteti do të krijojë një grup teknik në përputhje me rregulloren 7 për të shqyrtuar propozimet e paraqitura në përputhje me paragrafin 1 të kësaj rregulloreje.

4. Grupi teknik do të shqyrtojë propozimin së bashku me çdo të dhënë shtesë, duke përfshirë vendimet e miratuara nga organe të tjera ndërkombëtare në lidhje me listat e tyre të materialeve ose substancave të rrezikshme, të paraqitura nga çdo subjekt i interesuar, dhe do të vlerësojë dhe raportojë në Komitet nëse materiali i rrezikshëm në fjalë, në kontekstin e kësaj Konvente, mund të shkaktojë efekte negative të rëndësishme në shëndetin e njeriut ose mjedisin, të tilla që ndryshimi i shtojcës 1 ose shtojcës 2 është i garantuar. Në këtë aspekt:

1. Rishikimi i grupit teknik duhet të përfshijë:

1.1 një vlerësim të lidhjes ndërmjet materialit të rrezikshëm në fjalë dhe mundësisë, në kontekstin e kësaj Konvente, që do të çojë në efekte të rëndësishme negative në shëndetin e njeriut ose mjedis, bazuar në të dhënat e paraqitura ose të dhëna të tjera përkatëse të sjella në vëmendje të grupit;

1.2 një vlerësim të reduktimit të rrezikut të mundshëm që i atribuohet masave të propozuara të kontrollit dhe çdo mase tjetër kontrolli që mund të merret parasysh nga grupi teknik;

1.3 shqyrtimin e informacionit të disponueshëm mbi fizibilitetin teknik të masave të kontrollit;

1.4 shqyrtimin e informacionit të disponueshëm mbi efektet e tjera që rrjedhin nga prezantimi i këtyre masave të kontrollit në lidhje me:

- mjedisin;

- shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, përfshirë atë të marinarëve dhe punëtorëve; dhe

- koston për transportin ndërkombëtar dhe sektorët e tjerë përkatës.

1.5 shqyrtimin e disponueshmërisë së alternativave të përshtatshme për materialin e rrezikshëm që do të kontrollohet, duke përfshirë një shqyrtim të rreziqeve të mundshme të alternativave;

1.6 shqyrtimin e rreziqeve të paraqitura nga materiali i rrezikshëm gjatë procesit të riciklimit; dhe

1.7 shqyrtimin e vlerave të përshtatshme të pragut dhe çdo përjashtimi të dobishëm ose të nevojshëm.

2. Nëse grupi teknik konstaton se materiali i rrezikshëm në fjalë, në kontekstin e kësaj Konvente, mund të shkaktojë efekte negative të konsiderueshme në shëndetin e njeriut ose mjedisin, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk do të përdoret si arsye për të parandaluar që grupi që të vijojë me një vlerësim të propozimit.

3. Raporti i grupit teknik do të jetë me shkrim dhe do të marrë parasysh secilin prej vlerësimeve dhe konsideratave të përmendura në nënparagrafin 1, përveç kur grupi teknik mund të vendosë të mos vijojë me vlerësimet dhe konsideratat e përshkruara në nënparagrafët 1.2 deri në 1.7, nëse ai përcakton pas vlerësimit në nënparagrafin 1.1 se propozimi nuk kërkon shqyrtim të mëtejshëm.

4. Raporti i grupit teknik do të përfshijë, *ndër të tjera*, një rekomandim nëse kontrollet ndërkombëtare në përputhje me këtë Konventë janë të garantuara për materialin e rrezikshëm në fjalë, për përshtatshmërinë e masave specifike të kontrollit të sugjeruara në propozimin gjithëpërfshirës ose për masa të tjera kontrolli që beson se janë më të përshtatshme.

5. Komiteti do të vendosë nëse do të miratojë ndonjë propozim për të ndryshuar shtojcën 1 ose shtojcën 2, dhe çdo modifikim të tyre, nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh raportin e grupit teknik. Çdo ndryshim i propozuar do të specifikojë zbatimin e ndryshimit për anijet e certifikuara në përputhje me këtë Konventë përpara hyrjes në fuqi të një ndryshimi të tillë. Nëse raporti konstaton se materiali i rrezikshëm në fjalë, në kontekstin e kësaj Konvente, mund të shkaktojë efekte negative të konsiderueshme në shëndetin e njeriut ose mjedisin, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk do të përdoret si arsye për të penguar marrjen e një vendimi për të renditur një material të rrezikshëm në shtojcën 1 ose shtojcën 2. Një vendim për të mosmiratuar propozimin nuk do të përjashtojë paraqitjen e ardhshme të një propozimi të ri në lidhje me një material të rrezikshëm të caktuar nëse zbulohet informacion i ri.

Rregullorja 7 - Grupet teknike

1. Komiteti mund të krijojë një ose më shumë grupe teknike në përputhje me rregulloren 6, sipas nevojës. Grupi teknik mund të përbëhet nga përfaqësues të palëve, anëtarë të organizatës, Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara, organizata ndërqeveritare që kanë marrëveshje me organizatën dhe organizata joqeveritare në status konsultimi me organizatën të cilat preferohet të përfshijnë përfaqësues të institucioneve dhe laboratorë me ekspertizë për fatin mjedisor dhe efektet e substancave, efektet toksikologjike, biologjia detare, shëndeti i njeriut, analiza ekonomike, administrimi i rrezikut, ndërtimi i anijeve, transporti ndërkombëtar, shëndeti dhe siguria në punë ose fusha të tjera ekspertize të nevojshme për të shqyrtuar objektivisht meritat teknike të një propozimi.

2. Komiteti vendos për kushtet e referencës, organizimin, pjesëmarrjen dhe funksionimin e grupeve teknike. Kushte të tilla do të garantojnë mbrojtjen e çdo informacioni konfidencial që mund të dorëzohet. Grupet teknike mund të mbajnë takime të tilla sipas nevojës, por do të përpiqen të kryejnë punën e tyre nëpërmjet korrespondencës së shkruar ose elektronike ose mënyrave të tjera, sipas rastit.

3. Vetëm përfaqësuesit e Palëve mund të marrin pjesë në formulimin e çdo rekomandimi për Komitetin, në përputhje me rregulloren 6. Një grup teknik do të përpiqet të arrijë unanimitet ndërmjet përfaqësuesve të Palëve. Nëse unanimiteti nuk është i mundur, grupi teknik do të komunikojë çdo pikëpamje të pakicës së këtyre përfaqësuesve.

PJESA B

PËRGATITJA PËR RICIKLIMIN E ANIJEVE

Rregullorja 8 - Kërkesa të përgjithshme

Anijet e synuara për t'u ricikluar, duhet:

1. të riciklohen vetëm në objektet/hapësirat e riciklimit të anijeve që janë:

1) të autorizuar në përputhje me këtë Konventë; dhe

2) plotësisht të autorizuar për të ndërmarrë të gjithë riciklimin e anijes që Plani i Riciklimit të Anijeve specifikon se do të kryhet nga objekti/et e identifikuar të riciklimit të anijeve:

2. Kryejnë operacione në periudhën para hyrjes në objektin e riciklimit të anijeve për të minimizuar sasinë e mbetjeve të ngarkesave, karburantit të mbetur dhe mbetjeve në bord;

3. në rastin e një cisterne, anija duhet të mbërrijë në objektin e riciklimit të anijes me rezervuarë ngarkesash dhe hapësirë pompash në një gjendje që është gati për certifikim si të sigurt për hyrje, ose të sigurt për të kryer punë që lidhen me nxehtësinë, ose të dyja, sipas ligjeve kombëtare, rregulloreve dhe politikave të Palës nën juridiksionin e së cilës operon objekti i riciklimit të anijeve;

4. t'i paraqesin objektit të riciklimit të anijes të gjithë informacionin e disponueshëm në lidhje me anijen për hartimin e Planit të Riciklimit të Anijeve të kërkuar nga rregullorja 9:

5. të plotësojnë inventarin e kërkuar nga rregullorja 5; dhe

6. të jenë të certifikuar si të gatshme për riciklim nga administrata ose organizata e njohur prej saj, përpara se të kryhet ndonjë aktivitet riciklimi.

Rregullorja 9 - Plani i riciklimit të anijeve

Një Plan Riciklimi i Anijeve specifike për anijen do të hartohet nga objekti/et e riciklimit të anijeve përpara çdo riciklimi të një anijeje, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata. Plani i riciklimit të anijes:

1. do të hartohet duke marrë parasysh informacionin e dhënë nga pronari i anijes,

2. do të hartohet në gjuhën e pranuar nga Pala që autorizon objektin e riciklimit të anijeve dhe nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht, frëngjisht ose spanjisht, plani i riciklimit të anijes do të përkthehet në një nga këto gjuhë, përveç rasteve kur administrata është e bindur se kjo nuk është e nevojshme;

3. do të përfshijë informacion në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e kushteve të punës së sigurt për hyrje dhe të sigurt për punë që lidhen me nxehtësinë dhe sesi do të menaxhohet lloji dhe sasia e materialeve, duke përfshirë ato të identifikuar në inventarin e materialeve të rrezikshme;

4. në përputhje me deklaratën e depozituar sipas nenit 16.6, të miratohet në mënyrë të qartë ose të heshtur nga Autoriteti Kompetent që autorizon objektin e riciklimit të anijes. Autoriteti Kompetent do të dërgojë konfirmimin me shkrim të marrjes së Planit të Riciklimit të Anijes objektit të riciklimit të anijes, pronarit të anijes dhe administratës brenda 3 (tri) ditëve të punës nga marrja e tij në përputhje me rregulloren 24. Më pas:

1) kur një Palë kërkon miratimin e qartë të Planit të Riciklimit të Anijes, Autoriteti Kompetent do t'i dërgojë një njoftim me shkrim për vendimin e tij për të miratuar ose refuzuar Planin e Riciklimit të Anijes objektit të riciklimit të anijes, pronarit të anijes dhe administratës; dhe

2) kur një Palë kërkon miratimin e heshtur të planit të riciklimit të anijes, konfirmimi i marrjes do të specifikojë datën e përfundimit të një periudhe rishikimi 14 ditë para. Autoriteti Kompetent do të njoftojë çdo kundërshtim me shkrim ndaj Planit të Riciklimit të Anijes objektit të riciklimit të anijes, pronarit të anijes dhe administratës brenda kësaj periudhe 14-ditore të shqyrtimit. Kur një kundërshtim i tillë me shkrim nuk është njoftuar, plani i riciklimit të anijes do të konsiderohet i miratuar.

5. pasi të miratohet në përputhje me paragrafin 4, të vihet në dispozicion për inspektim nga administrata ose çdo gjeodet ose organizatë e emëruar e njohur prej saj; dhe

6. kur përdoren më shumë se një objekt riciklimi të anijeve, duhet të identifikojë objektet e riciklimit të anijeve që do të përdoren dhe të specifikojë aktivitetet e riciklimit dhe rendin në të cilin ndodhin në çdo objekt riciklimi të autorizuar të anijes.

PJESA C INSPEKTIMET DHE CERTIFIKIMI

Rregullorja 10 - Inspektimet

1. Anijet për të cilat zbatohet kjo Konventë, do t'u nënshtrohen kontrolleve të specifikuar më poshtë:

1) një inspektim fillestar përpara se anija të vihet në shërbim, ose përpara se të lëshohet certifikata ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme. Ky inspektim do të verifikojë që pjesa I e inventarit të kërkuar nga rregullorja 5 është në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente;

2) një inspektim rinovimi në intervale të përcaktuara nga administrata, por jo më shumë se pesë vjet. Ky inspektim do të verifikojë që pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme që kërkohet nga rregullorja 5, përputhet me kërkesat e kësaj Konvente;

3) një inspektim shtesë, i përgjithshëm ose i pjesshëm, sipas rrethanave, mund të kryhet me kërkesë të pronarit të anijes pas një ndryshimi, zëvendësimi ose riparimi të konsiderueshëm të strukturës,

pajisjeve, sistemeve, rregullimeve dhe materialit. Inspektimi duhet të jetë i tillë që të garantojë që çdo ndryshim, zëvendësim ose riparim i rëndësishëm të jetë bërë në mënyrën sesi anija të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente dhe se pjesa I e inventarit është ndryshuar sipas nevojës; dhe

4. një inspektim përfundimtar përpara se anija të dalë jashtë shërbimit dhe përpara se të fillojë riciklimi i anijes. Ky inspektim do të verifikojë:

1) që inventari i materialeve të rrezikshme, siç kërkohet nga rregullorja 5.4, është në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata;

2) që Plani i Riciklimit të Anijeve, siç kërkohet nga rregullorja 9, pasqyron siç duhet informacionin e përfshirë në Inventarin e Materialeve të Rrezikshme siç kërkohet nga rregullorja 5.4 dhe përmban informacion në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e :I sigurt për hyrje dhe i sigurt në kushte pune që lidhen me nxehtësinë”; dhe

3) që objekti/et e riciklimit të anijes ku anija do të riciklohet, ka një autorizim të vlefshëm në përputhje me këtë Konventë.

2. Vrojtimit e anijeve për qëllimin e zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente do të kryhen nga nëpunësit e administratës, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata. Megjithatë, administrata mund t’ua besojë inspektimet gjeodetëve të emëruar për këtë qëllim ose organizatave të njohura prej saj.

3. Një administratë që emëron gjeodetë ose njeh organizata për të kryer inspektime, siç përshkruhet në paragrafin 2, do të autorizojë, minimalisht, gjeodetët e emëruar ose organizatat e njohura që:

1) kërkojnë që një anije që ata do të vëzhgojnë, të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente; dhe

2) kryejnë survejime dhe inspektime nëse kërkohet nga autoritetet përkatëse të një shteti portual që është Palë.

4. Në çdo rast, administrata përkatëse do të jetë përgjegjëse për të garantuar plotësinë dhe efikasitetin e studimit dhe do të marrë përsipër të garantojë masat e nevojshme për të përmbushur këtë detyrim.

5. Vrojtimit fillestar dhe të rinovimit duhet të harmonizohen me inspektimet e kërkuara nga dokumentet e tjera ligjore statutores të zbatueshme të organizatës.

Rregullorja 11 - Lëshimi dhe miratimi i certifikatave

1. Një certifikatë ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme do të lëshohet ose nga administrata, ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj pas përfundimit të suksesshëm të një studimi fillestar ose rinovues të kryer në përputhje me rregulloren 10, për çdo anije për të cilën zbatohet rregullorja 10, me përjashtim të anijeve ekzistuese për të cilat kryhen njëkohësisht një inspektim fillestar dhe një inspektim përfundimtar, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

2. Certifikata ndërkombëtare mbi inventarin e materialeve të rrezikshme, e lëshuar sipas paragrafit 1, me kërkesë të pronarit të anijes, do të miratohet ose nga administrata ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj pas përfundimit me sukses të një inspektimi shtesë të kryer në përputhje me rregulloren 10.

3. Pavarësisht rregullores 14.2 dhe kërkesave të rregullores 10.1.2, kur inspektimi i rinovimit përfundon brenda tre muajve përpara datës së skadimit të certifikatës ekzistuese, certifikata e re do të jetë e vlefshme nga data e përfundimit të inspektimit të rinovimit deri në një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të certifikatës ekzistuese.

4. Kur inspektimi i rinovimit përfundon pas datës së skadimit të certifikatës ekzistuese, certifikata e re do të jetë e vlefshme nga data e përfundimit të inspektimit të rinovimit deri në një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të certifikatës ekzistuese.

5. Kur inspektimi i rinovimit përfundon më vonë se tre muaj përpara datës së skadimit të certifikatës ekzistuese, certifikata e re do të jetë e vlefshme nga data e përfundimit të inspektimit të rinovimit deri në një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e përfundimit të inspektimit të rinovimit.

6. Nëse një certifikatë lëshohet për një periudhë më pak se pesë vjet, administrata mund të zgjasë vlefshmërinë e certifikatës pas datës së skadimit deri në periudhën maksimale të specifikuar në rregulloren 10.1.2.

7. Nëse një inspektim i rinovimit është përfunduar dhe një certifikatë e re nuk mund të lëshohet ose vendoset në bordin e anijes përpara datës së skadimit të certifikatës ekzistuese, personi ose organizata e autorizuar nga administrata mund të miratojë certifikatën ekzistuese dhe një certifikatë e tillë do të pranohet si e vlefshme për një periudhë të mëtejshme e cila nuk do të kalojë pesë muaj nga data e skadimit.

8. Nëse një anije, në kohën kur skadon një certifikatë, nuk është në një port ku do të kontrollohet, administrata mund të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së certifikatës, por kjo kohëzgjatje do të jepet vetëm për qëllimin e lejimit të anijes për të përfunduar udhëtimin e saj në portin ku do të inspektohet dhe më pas vetëm në rastet kur gjykohej e arsyeshme për ta bërë këtë. Asnjë certifikatë nuk do të zgjatet për një periudhë më të gjatë se tre muaj dhe një anije të cilës i jepet një kohëzgjatje më e madhe nuk do të ketë të drejtë, me mbërritjen e saj në portin ku do të kontrollohet, të largohet nga ai port për shkak të kësaj kohëzgjatjeje, pa pasur një certifikatë të re. Kur inspektimi i rinovimit të përfundojë, certifikata e re do të jetë e vlefshme deri në një datë që nuk kalon pesë vjet nga data e skadimit të certifikatës ekzistuese përpara se të miratohej zgjatja e afatit të skadimit të certifikatës në fjalë.

9. Një certifikatë e lëshuar për një anije të angazhuar në udhëtime të shkurtra, të cilës nuk i është zgjatuar afati sipas dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje, mund të zgjatet nga administrata për një periudhë mospagimi deri në një muaj nga data e skadimit të përcaktuar në të. Kur inspektimi i rinovimit të përfundojë, certifikata e re do të jetë e vlefshme deri në një datë që nuk i kalon pesë vjet nga data e skadimit të certifikatës ekzistuese përpara se të miratohej zgjatja e afatit të përfundimit të saj.

10. Në rrethana të veçanta, siç përcaktohet nga administrata, nuk është e nevojshme që një certifikatë e re të datohet nga data e skadimit të certifikatës ekzistuese siç kërkohet nga paragrafët 4, 8 ose 9 i kësaj rregulloreje. Në këto rrethana të veçanta, certifikata e re do të jetë e vlefshme deri në një datë që nuk kalon pesë vjet nga data e përfundimit të inspektimit të rinovimit.

11. Një certifikatë ndërkombëtare për gatishmëri për riciklim do të lëshohet nga administrata ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj, pas përfundimit të suksesshëm të një inspektimi përfundimtar në përputhje me dispozitat e rregullores 10, për çdo anije për të cilën zbatohet rregullorja 10, duke marrë parasysh autorizimin e objektit të riciklimit të anijeve dhe udhëzimet e hartuara nga organizata.

12. Një certifikatë e lëshuar nën autoritetin e një Pale do të pranohet nga Palët e tjera dhe do të konsiderohet për të gjitha qëllimet e mbuluara nga kjo Konventë se ka të njëjtën vlefshmëri si një certifikatë e lëshuar prej tyre. Certifikatat do të lëshohen ose miratohen nga Administrata ose nga çdo person ose organizatë e autorizuar në formë ligjore prej saj. Në çdo rast, administrata merr përsipër përgjegjësinë e plotë për certifikatën.

Rregullorja 12 - Lëshimi ose miratimi i një certifikate nga një Palë tjetër

1. Me kërkesë të administratës, një Palë tjetër mund të marrë masa që një anije të inspektohet dhe, nëse bindet se dispozitat e kësaj Konvente respektohen, do të lëshojë ose autorizojë lëshimin e një certifikate për anijen dhe, sipas rastit, të miratojë ose autorizojë miratimin e asaj certifikate në anije, në përputhje me këtë shtojcë.

2. Një kopje e certifikatës dhe një kopje e raportit të inspektimit do t'i transmetohen sa më shpejt të jetë e mundur administratës kërkuese.

3. Një certifikatë e lëshuar në këtë mënyrë do të përmbajë një deklaratë për efektin që është lëshuar me kërkesë të administratës dhe do të ketë të njëjtën fuqi si një certifikatë e lëshuar nga administrata.

4. Asnjë certifikatë nuk do t'i lëshohet një anijeje që ka të drejtë të mbajë flamurin e një shteti që nuk është palë.

Rregullorja 13 - Formulari i certifikatave

Certifikatat do të hartohen në një gjuhë zyrtare të Palës lëshuese, në formën e përcaktuar në shtojcat 3 dhe 4. Nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht, frëngjisht ose spanjisht, teksti duhet të përfshijë një përkthim në një nga këto gjuhë. Megjithatë, administrata mund të lëshojë certifikatën ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme të hartuar vetëm në një gjuhë zyrtare të Palës lëshuese për anijet që nuk janë të angazhuara në udhëtime drejt porteve ose terminaleve në det nën juridiksionin e Palëve të tjera në këtë Konventë dhe certifikatën ndërkombëtare për gatishmërinë për riciklim, të hartuar vetëm në një gjuhë zyrtare të palës lëshuese për anijet e ricikluara në objektet e riciklimit të anijeve nën juridiksionin e palës lëshuese.

Rregullorja 14 - Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e certifikatave

1. Një certifikatë ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme, e lëshuar sipas rregulloreve 11 ose 12, nuk do të konsiderohet e vlefshme në një nga rastet e mëposhtme:

1) nëse gjendja e anijes nuk korrespondon kryesisht me të dhënat e certifikatës, duke përfshirë rastin kur pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme nuk mirëmbahet dhe përditësohet siç duhet, duke reflektuar ndryshime në strukturën dhe pajisjet e anijes, në përputhje me udhëzimet e hartuara nga Organizata;

2) me transferimin e anijes në flamurin e një shteti tjetër. Një certifikatë e re do të lëshohet vetëm kur Pala që lëshon certifikatën e re është plotësisht e bindur se anija është në përputhje me kërkesat e rregullores 10. Në rastin e një transferimi ndërmjet palëve, nëse kërkohet brenda tre muajve pas kryerjes së transferimit, Pala, flamurin e së cilës e mbante anija më parë, duhet t'i transmetojë administratës, sa më shpejt të jetë e mundur, kopjet e certifikatave të mbajtura nga anija përpara transferimit dhe, nëse janë të disponueshme, kopje të raporteve përkatëse të inspektimit;

3) nëse inspektimi i rinovimit nuk përfundon brenda periudhave të përcaktuara në rregulloret 10.1 dhe 11; ose

4) nëse certifikata nuk është miratuar në përputhje me rregulloret 11 ose 12.

2. Një certifikatë ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme do të lëshohet për një periudhë të përcaktuar nga administrata, e cila nuk do të kalojë pesë vjet.

3. Një certifikatë ndërkombëtare për gatishmërinë për riciklim do të lëshohet për një periudhë të përcaktuar nga administrata që nuk duhet të kalojë tre muaj.

4. Një certifikatë ndërkombëtare për gatishmërinë për riciklim, e lëshuar sipas rregulloreve 11 ose 12, nuk do të konsiderohet e vlefshme nëse gjendja e anijes nuk korrespondon kryesisht me të dhënat e certifikatës.

5. Afati i një certifikate ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim mund të zgjatet nga administrata apo nga çdo person ose organizatë e autorizuar prej saj për një udhëtim nga një pikë në një pikë tjetër drejt objektit të riciklimit të anijes.

KAPITULLI 3 KËRKESAT PËR OBJEKTET E RICIKLIMIT TË ANIJEVE

Rregullorja 15 - Kontrollat në objektet e riciklimit të anijeve

1. Secila Palë do të vendosë legjislacionin, rregulloret dhe standardet që janë të nevojshme për të garantuar që objektet e riciklimit të anijeve janë projektuar, ndërtuar dhe operuar në mënyrë të sigurt që nuk dëmtojnë mjedisin në përputhje me rregulloret e kësaj Konvente.

2. Secila Palë do të krijojë një mekanizëm për autorizimin e objekteve të riciklimit të anijeve me kushte të përshtatshme për të garantuar që objektet e tilla të riciklimit të anijeve plotësojnë kërkesat e kësaj Konvente.

3. Secila Palë do të krijojë një mekanizëm për të garantuar që objektet e riciklimit të anijeve janë në përputhje me kërkesat e këtij kapitulli, duke përfshirë krijimin dhe përdorimin efektiv të dispozitave të inspektimit, monitorimit dhe zbatimit, përfshirë kompetencat për hyrjen dhe marrjen e mostrave. Një mekanizëm i tillë mund të përfshijë një skemë auditimi që do të kryhet nga autoriteti/et kompetent ose një organizatë e njohur nga Pala, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata dhe rezultatet e këtyre auditimeve duhet t'i komunikohen organizatës.

4. Secila Palë do të caktojë një ose më shumë Autoritete Kompetente dhe pikën e vetme të kontaktit që do të përdoret nga organizata, Palët në këtë Konventë dhe subjekte të tjera të interesuara për çështjet që lidhen me objektet e riciklimit të anijeve që operojnë brenda juridiksionit të asaj Pale.

Rregullorja 16 - Autorizimi i objekteve të riciklimit të anijeve

1. Objektet e riciklimit të anijeve që riciklojnë anijet për të cilat zbatohet kjo Konventë, ose anijet e trajtuara në mënyrë të ngjashme në përputhje me nenin 3.4, do të autorizohen nga një Palë duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

2. Autorizimi do të kryhet nga autoriteti/et kompetent dhe do të përfshijë verifikimin e dokumentacionit të kërkuar nga kjo Konventë dhe një inspektim në terren. Megjithatë, autoriteti/et

kompetent mund t'ia besojë autorizimin e objekteve të riciklimit të anijeve organizatave të njohura prej tij.

3. Pala do të njoftojë organizatën për përgjegjësitë dhe kushtet specifike të autoritetit të deleguar tek organizatat e njohura, për qarkullim te Palët. Në çdo rast, autoriteti/et kompetent mbajnë përgjegjësinë e plotë për autorizimin e lëshuar.

4. Autorizimi do të hartohet në formën e përcaktuar në shtojcën 5. Nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht, frëngjisht ose spanjisht, teksti duhet të përfshijë një përkthim në një nga këto gjuhë.

5. Autorizimi do të jetë i vlefshëm për një periudhë të caktuar nga Pala, por jo më shumë se pesë vjet. Pala do të identifikojë kushtet për të cilat autorizimi do të lëshohet, tërhiqet, pezullohet, ndryshohet dhe rinovohet dhe t'ia komunikojë këto kushte objekteve të riciklimit të anijes. Nëse një objekt riciklimi i anijes refuzon inspektimin nga autoriteti/et kompetent ose organizata e njohur që vepron në emër të tij/tyre, autorizimi do të pezullohet ose tërhiqet.

6. Nëse incidentet ose veprimet e ndërmarra në objektin e riciklimit të anijes kanë efekt që kushtet për autorizimin nuk mund të përmbushen, objekti i riciklimit të anijes do të informojë autoritetin/et kompetent. Autoriteti/et kompetente mund të vendosin, në përputhje me rrethanat, të pezullojnë ose tërheqin autorizimin, ose të kërkojnë veprime korigjuese nga objekti i riciklimit të anijeve.

Rregullorja 17 - Kërkesa të përgjithshme

1. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuar nga një palë do të krijojnë sisteme, procedura dhe teknika menaxhimi që nuk paraqesin rreziqe shëndetësore për punëtorët në fjalë ose për popullatën në afërsi të objektit të riciklimit të anijes dhe që do të parandalojnë, reduktojnë, minimizojnë dhe në masën e arsyeshme eliminojnë efektet negative në mjedis të shkaktuara nga riciklimi i anijeve, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

2. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuar nga një palë, për anijet për të cilat zbatohet kjo Konventë, ose anijet që operojnë në mënyrë të ngjashme sipas nenit 3.4:

1) pranojnë vetëm anije që:

1) janë në përputhje me këtë Konventë; ose

2) plotësojnë kërkesat e kësaj Konvente;

2. pranojnë vetëm anije të cilat janë të autorizuar t'i riciklojnë; dhe

3. kanë në dispozicion dokumentacionin e autorizimit të tij nëse një dokumentacion i tillë kërkohet nga një pronar anijeje që po shqyrton riciklimin e një anijeje në atë objekt riciklimi të anijes.

Rregullorja 18 - Plani i objektit të riciklimit të anijeve

Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuar nga një palë do të përgatisin një plan të objektit të riciklimit të anijes. Plani do të miratohet nga bordi ose organi përkatës drejtues i Shoqërisë së Riciklimit dhe do të përfshijë:

1. një politikë që garanton sigurinë e punëtorëve dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, duke përfshirë vendosjen e objektivave që çojnë në minimizimin dhe eliminimin në masën e mundshme të efekteve negative në shëndetin e njeriut dhe mjedis, të shkaktuara nga riciklimi i anijeve;

2. një sistem për të garantuar zbatimin e kërkesave të përcaktuara në këtë Konventë, arritjen e qëllimeve të përcaktuara në politikën e Shoqërisë së Riciklimit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave dhe standardeve të përdorura në operacionet e riciklimit të anijeve;

3. identifikimin e roleve dhe përgjegjësive për punëdhënësit dhe punëtorët gjatë kryerjes së operacioneve të riciklimit të anijeve;

4. një program për sigurimin e informacionit të duhur dhe trajnimin e punëtorëve për funksionimin e sigurt të objektit të riciklimit të anijeve dhe që nuk dëmton mjedisin;

5. një plan gatishmërie dhe reagimi ndaj emergjencave;

6. një sistem për monitorimin e performancës së riciklimit të anijeve;

7. një sistem regjistrimi që tregon sesi kryhet riciklimi i anijeve;

8. një sistem për raportimin e shkarkimeve, incidenteve dhe aksidenteve që shkaktjnë dëme, ose me potencial për të shkaktuar dëme, për sigurinë e punëtorëve, shëndetin e njeriut dhe mjedis.

9. një sistem për raportimin e sëmundjeve profesionale, aksidenteve, lëndimeve dhe efekteve të tjera negative në sigurinë e punëtorëve dhe shëndetin e njeriut, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

Rregullorja 19 - Parandalimi i efekteve negative për shëndetin e njeriut dhe mjedisin

Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të krijojnë dhe përdorin procedura, për:

1. të parandaluar shpërthimet, zjarret dhe kushte të tjera të pasigurta, duke garantuar që kushtet dhe procedurat e punës të sigurta për nxehtësinë të vendosen, mirëmbahen dhe monitorohen gjatë gjithë riciklimit të anijeve;

2. të parandaluar dëmtimet nga atmosferat e rrezikshme dhe kushtet e tjera të pasigurta, duke garantuar që kushtet dhe procedurat e sigurta për hyrje janë krijuar, mirëmbajtur dhe monitoruar në hapësirat e anijeve, përfshirë hapësirat e izoluar dhe hapësirat e mbyllura, gjatë gjithë riciklimit të anijes;

3. të parandaluar aksidentet e tjera, sëmundje dhe lëndime profesionale ose efekte të tjera negative në shëndetin e njerëzve dhe mjedis; dhe

4. të parandaluar derdhjet ose emetimet gjatë riciklimit të anijes të cilat mund të shkaktojnë dëm për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedis, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata.

Rregullorja 20 - Menaxhimi i sigurt dhe jo i dëmshëm për mjedisin i materialeve të rrezikshme

1. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të garantojnë heqjen e sigurt dhe jo të dëmshme për mjedisin të çdo materiali të rrezikshëm që gjendet në një anije të certifikuar në përputhje me rregulloret 11 ose 12. Personi/at përgjegjës për operacionet e riciklimit dhe punëtorët duhet të jenë të njohur me kërkesat e kësaj Konvente në lidhje me detyrat e tyre dhe, në veçanti, të përdorin në mënyrë aktive inventarin e materialeve të rrezikshme dhe Planin e Riciklimit të Anijeve, përpara dhe gjatë heqjes së materialeve të rrezikshme.

2. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të garantojnë që të gjitha materialet e rrezikshme të detajuara në inventar të identifikohen, etiketohen, paketohen dhe hiqen në masën maksimale të mundshme përpara prerjes nga punëtorët të trajtuar dhe të pajisur siç duhet, duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata, veçanërisht:

1) lëngje, mbetje dhe sedimente të rrezikshme;

2) substanca ose objekte që përmbajnë metale të rënda si plumbi, zhiva, kadmiumi dhe kromi gjashtëvalent;

3) bojëra dhe veshje që janë tejet të ndezshme dhe/ose çojnë në çlirime toksike;

4) asbest dhe materiale që përmbajnë asbest;

5) PCB dhe materiale që përmbajnë PCB, duke garantuar që pajisjet që shkaktojnë nxehtësi të shmangen gjatë operacioneve të tilla;

6) CFC dhe halonet; dhe

7) Materiale të tjera të rrezikshme që nuk janë renditur më sipër dhe që nuk janë pjesë e strukturës së anijes.

3. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një Palë do të garantojnë menaxhim të sigurt dhe të padëmshëm për mjedisin të të gjitha materialeve dhe mbetjeve të rrezikshme të hequra nga anija e ricikluar në atë objekt riciklimi anijesh. Vendet e menaxhimit dhe depozitimit të mbetjeve duhet të identifikohen për të garantuar menaxhim të mëtjeshëm të materialeve, të sigurt dhe të padëmshëm për mjedisin.

4. Të gjitha mbetjet e krijuara nga aktiviteti i riciklimit duhet të mbahen të ndara nga materialet dhe pajisjet e ricikluar, të etiketuara, të depozituara në kushte të përshtatshme që nuk paraqesin rrezik për punëtorët, shëndetin e njeriut ose mjedis dhe të transferohen vetëm në një strukturë të menaxhimit të mbetjeve të autorizuar për t'u trajtuar dhe asgjësuar në mënyrë të sigurt dhe të padëmshme për mjedisin.

Rregullorja 21 - Gatishmëria dhe reagimi ndaj emergjencave

Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të krijojnë dhe mbajnë një plan gatishmërie dhe reagimi emergjent. Plani do të përgatitet duke pasur parasysh vendndodhjen dhe mjedisin e objektit të riciklimit të anijes dhe do të marrë parasysh madhësinë dhe natyrën e aktiviteteve që lidhen me çdo operacion riciklimi të anijes. Plani, gjithashtu, do të:

1. sigurojë që pajisjet dhe procedurat e nevojshme që duhen ndjekur në rast emergjence janë të instaluar dhe që trajnimet të kryhen mbi baza të rregullta;

2. sigurojë që informacioni i nevojshëm, komunikimi i brendshëm dhe koordinimi të garantohen për të mbrojtur të gjithë njerëzit dhe mjedisin në rast emergjence në objektin e riciklimit të anijes;

3. sigurojë komunikim dhe informacion për autoritetin/et përkatëse kompetente, shërbimet për fqinjët dhe reagimin ndaj emergjencave;

4. sigurojë ndihmën e parë dhe ndihmën mjekësore, shuarjen e zjarrit dhe evakuimin e të gjithë njerëzve në objektin e riciklimit të anijeve, parandalimin e ndotjes; dhe

5. sigurojë informacionin dhe trajnimin përkatës për të gjithë punonjësit e objektit të riciklimit të anijeve, në të gjitha nivelet dhe sipas kompetencës së tyre, duke përfshirë ushtrime të rregullta në procedurat e parandalimit, gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave.

Rregullorja 22 - Siguria dhe trajnimi i punëtorëve

1. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të garantojnë sigurinë e punëtorëve me masa që përfshijnë:

1) garantimin e disponueshmërisë, mirëmbajtjes dhe përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale dhe veshjeve të nevojshme për të gjitha operacionet e riciklimit të anijeve;

2) garantimin që ofrohen programe trajnimi për t'u mundësuar punëtorëve të ndërmarrin në mënyrë të sigurt të gjitha operacionet e riciklimit të anijeve që kanë për detyrë ta bëjnë; dhe

3) garantimin që të gjithë punëtorët në objektin e riciklimit të anijeve të jenë pajisur me trajnimin dhe familjarizimin përpara se të kryejnë operacione të riciklimit të anijes.

2. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një palë do të garantojnë përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse për operacionet që kërkojnë një përdorim të tillë, duke përfshirë:

1) mbrojtje të kokës;

2) mbrojtje për fytyrën dhe sytë;

3) mbrojtje për duart dhe këmbët;

4) pajisje mbrojtëse të frymëmarrjes;

5) mbrojtje të dëgjimit;

6) mbrojtje kundër ndotjes radioaktive;

7) mbrojtje nga rënia; dhe

8) veshje të përshtatshme.

3. Objektet e riciklimit të anijeve, të autorizuara nga një palë, mund të bashkëpunojnë për të garantuar trajnimin e punëtorëve. Duke marrë parasysh udhëzimet e hartuara nga organizata, programet e trajnimit të përcaktuara në paragrafin 1.2 të kësaj rregulloreje, duhet të:

1. mbulojnë të gjithë punëtorët, duke përfshirë personelin kontraktues dhe punonjësit në objektin e riciklimit të anijeve;

2. kryhen nga persona kompetentë;

3. sigurojnë trajnim fillestar dhe të përditësuar në intervale të përshtatshme;

4. përfshijnë vlerësimin e pjesëmarrësve për të kuptuarit e tyre dhe zhvillimin e trajnimit;

5. rishikohen periodikisht dhe të modifikohen sipas nevojës; dhe

6. të jenë të dokumentuar.

Rregullorja 23 - Raportimi për incidentet, aksidentet, sëmundjet profesionale dhe efektet kronike

1. Objektet e riciklimit të anijeve të autorizuara nga një Palë do t'i raportojnë autoritetit/eve kompetent/e çdo incident, aksident, sëmundje profesionale ose efekte kronike që mund të shkaktojnë rreziqe për sigurinë e punëtorëve, shëndetin e njeriut dhe mjedis.

2. Raportet duhet të përmbajnë një përshkrim të incidentit, aksidentit, sëmundjes profesionale ose efektit kronik, shkakut të tij, veprimet të reagimit të ndërmarrë dhe pasojave dhe veprimeve korrigjuese që duhen ndërmarrë.

KAPITULLI 4 KËRKESAT PËR RAPORTIM

Rregullorja 24 - Kërkesat për njoftimin fillestar dhe raportimin

1. Një pronar anijeje do të njoftojë administratën në kohën e duhur dhe me shkrim për qëllimin për riciklimin e një anijeje, në mënyrë që t'i mundësojë administratës të përgatitet për studimin dhe certifikimin e kërkuar nga kjo Konventë.

2. Një objekt riciklimi i anijes, kur përgatitet të marrë një anije për riciklim, duhet të njoftojë në kohën e duhur dhe me shkrim autoritetin/et e tij kompetente për qëllimin. Njoftimi duhet të përfshijë të paktën detajet e mëposhtme të anijes:

- 1) emrin e shtetit të flamurit që anija ka të drejtë të mbajë;
- 2) datën kur anija është regjistruar në atë shtet;
- 3) numrin e identifikimit të anijes (numri IMO)
- 4) numrin e trupit të anijes për dorëzimin e ndërtimeve të reja;
- 5) emrin dhe llojin e anijes;
- 6) portin në të cilin është regjistruar anija;
- 7) emrin dhe adresën e pronarit të anijes si dhe numrin e identifikimit të pronarit të regjistruar në IMO (Organizatën Ndërkombëtare Detare);
- 8) emrin dhe adresën e shoqërisë si dhe numrin e identifikimit të shoqërisë IMO;
- 9) emrin e të gjitha shoqërive të klasifikimit me të cilat klasifikohet anija;
- 10) të dhënat kryesore të anijes (gjatësia e përgjithshme (LOA), gjerësia, thellësia, pesha boshe, tonazhi bruto dhe neto, dhe lloji dhe vlerësimi i motorit)
- 11) inventarin e materialeve të rrezikshme; dhe
- 12) draft planin e riciklimit të anijeve për miratim në përputhje me rregulloren 9.

3. Kur anija e synuar për t'u ricikluar ka marrë certifikatën ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim, objekti i riciklimit të anijes do t'i raportojë autoritetit/eve kompetent/e të tij fillimin e planifikuar të riciklimit të anijes. Raporti duhet të jetë në përputhje me formatin e raportimit në shtojcën 6 dhe duhet të përfshijë të paktën një kopje të certifikatës ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim. Riciklimi i anijes nuk do të fillojë përpara paraqitjes së raportit.

Rregullorja 25 - Raportimi pas përfundimit

Kur riciklimi i pjesshëm ose i plotë i një anijeje përfundon në përputhje me kërkesat e kësaj Konvente, një deklaratë përfundimi do të lëshohet nga objekti i riciklimit të anijes dhe do t'i raportohet autoritetit/eve kompetent/e. Ky raport duhet të përpilohet siç tregohet në shtojcën 7.

Autoriteti/et kompetent/e do t'i dërgojnë një kopje të deklaratës Administratës që ka lëshuar Certifikatën Ndërkombëtare të Gatishmërisë për Riciklim për anijen. Deklarata do të lëshohet brenda 14 ditëve nga data e riciklimit të pjesshëm ose të përfunduar të anijes në përputhje me planin e riciklimit të anijes dhe do të përfshijë një raport mbi incidentet dhe aksidentet që dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin, nëse ka.

SHTOJCA 1 KONTROLI I MATERIALEVE TË RREZIKSHME

| Materiali i rrezikshëm | Përkufizimet | Masat e kontrollit |
|-----------------------------------|---|--|
| Asbesti | Materialet që përmbajnë asbest | Për të gjitha anijet, instalimi i ri i materialeve që përmbajnë asbest, do të ndalohet. |
| Substancat që shkatërrojnë ozonin | Substancat që shkatërrojnë ozonin nënkuptojnë substancat e kontrolluara të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 1 të Protokollit të Montrealit mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit, 1987, të listuara në shtojcat A, B, C ose E të Protokollit në fjalë në fuqi në kohën e aplikimit ose interpretimit të kësaj shtojce. Substancat që shkatërrojnë ozonin që mund të gjenden në bordin e anijes përfshijnë, por nuk kufizohen në: Halon 1211 Bromoklorodifluorometan Halon 1301 Bromotrifluorometan Halon 2402 1,2-Dibromo-1,1,2,2-tetrafluoroetan (i njohur gjithashtu si Halon 114B2) CFC-11 Triklorofluorometan CFC-12 Diklorodifluorometan CFC-113 1,1,2-Trikloro-1,2,2-trifluoroetan CFC-114 1,2-Dikloro-1,1,2,2-tetrafluoroetan CFC-115 Kloropentafluoroetan | Instalimet e reja që përmbajnë substanca që shkatërrojnë ozonin, do të ndalohen në të gjitha anijet, përveç instalimeve të reja që përmbajnë hidroklorofluorokarbure (HCFC) që lejohen deri më 1 janar 2020. |

| | | |
|--|---|--|
| Bifenilet e poliklorinuara (PCB) | Bifenilet e poliklorinuara nënkupton përbërje aromatike të formuara në një mënyrë që atomet e hidrogjenit në molekulën e bifenilit (dy unaza benzeni të lidhura së bashku nga një lidhje e vetme karbon-karbon) mund të zëvendësohen me deri dhjetë atome klori | Për të gjitha anijet, instalimi i ri i materialeve që përmbajnë bifenile të poliklorinuara do të ndalohej. |
| Përbërje kimike dhe sisteme kundër ndotjes | Përbërjet dhe sistemet kundër ndotjes të përcaktuara sipas shtojcës I të Konventës Ndërkombëtare për Kontrollin e Sistemeve të Dëmshme kundër ndotjes në Anije, 2001 (Konventa AFS) në fuqi në kohën e zbatimit ose interpretimit të kësaj shtojce. | 1. Asnjë anije nuk mund të aplikojë sisteme kundër ndotjes që përmbajnë komponime organotine si biocid ose ndonjë sistem tjetër kundër ndotjes, aplikimi ose përdorimi i të cilit është i ndaluar nga Konventa AFS. 2. Asnjë anije e re ose instalim i ri në anije nuk do të aplikojë ose përdorë përbërës ose sisteme kundër ndotjes në një mënyrë që nuk është në përputhje me Konventën AFS. |

SHTOJCA 2

LISTA MINIMALE E ARTIKUJVE PËR INVENTARIN E MATERIALIT TË RREZIKSHËM

| |
|---|
| Çdo material i rrezikshëm i listuar në shtojcën 1 |
| Kadmiumi dhe përbërjet e kadmiumit |
| Kromi gjashtëvalent dhe përbërjet e kromit gjashtëvalent |
| Plumbi dhe përbërjet e plumbit |
| Mërkuri dhe përbërjet e mërkurit |
| Bifenil i polibrominuar (PBB) |
| Eteret difenil të polibrominuar (PBDE) |
| Naftalenet e poliklorinuara (më shumë se 3 atome klori) |
| Substancat radioaktive |
| Disa parafina të klorinuara me zinxhir të shkurtër (alkane, C10-C13, kloro) |

SHTOJCA 3

FORMULARI I CERTIFIKATËS NDËRKOMBËTARE PËR INVENTARIN E MATERIALEVE TË RREZIKSHME

CERTIFIKATË NDËRKOMBËTARE PËR INVENTARIN E MATERIALEVE TË RREZIKSHME

(Shënim. Kjo certifikatë do të plotësohet nga pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme)

(Vula zyrtare) (Shteti)

Lëshuar sipas dispozitave të Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për riciklimin e Sigurt dhe Mjedisit të Anijeve, 2009 (në vijim e referuar si “Konventa”) nën autoritetin e qeverisë së

.....

(Emri i shtetit)

nga

(Përcaktimi i plotë i personit ose organizatës së autorizuar sipas dispozitave të Konventës)

Të dhënat e anijes

| | |
|------------------------------|--|
| Emri i anijes | |
| Numri ose shkronjat dalluese | |
| Porti i regjistrimit | |

| | |
|--|--|
| Tonazhi bruto | |
| Numri IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare) | |
| Emri dhe adresa e pronarit të anijes | |
| Numri IMO i identifikimit të pronarit të regjistruar | |
| Numri IMO i identifikimit të shoqërisë | |
| Data e ndërtimit | |

Të dhënat e pjesës I të inventarit të materialeve të rrezikshme

Pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme, numri i identifikimit/verifikimit:.....

Shënim. Pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme, siç kërkohet nga rregullorja 5 e shtojcës së Konventës, është pjesë thelbësore e certifikatës ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme dhe duhet të shoqërojë gjithmonë certifikatën ndërkombëtare për inventarin e materialeve të rrezikshme. Pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme duhet të përpilohet në bazë të formatit standard të treguar në udhëzimet e dhëna nga organizata.

VËRTETOHET SE:

1. anija është kontrolluar në përputhje me rregulloren 10 të shtojcës së Konventës; dhe
2. inspektimi tregon se pjesa I e inventarit të materialeve të rrezikshme përputhet plotësisht me kërkesat e zbatueshme të Konventës.

Data e përfundimit të inspektimit mbi të cilin bazohet kjo certifikatë.....(dd/mm/vvvv)

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më.....(dd/mm/vvvv)

Lëshuar në

(Vendi i lëshimit të certifikatës)

(dd/mm/vvvv)

(Data e lëshimit) (Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërisht i cili lëshon certifikatën)

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

MIRATIMI PËR ZGJATJEN E AFATIT TË CERTIFIKATËS, NËSE ËSHTË E VLEFSHME, PËR MË PAK SE PESË VJET KU ZBATOHET RREGULLORJA 11.6

Anija është në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës dhe kjo certifikatë, në përputhje me rregulloren 11.6 të shtojcës së Konventës, do të pranohet si e vlefshme deri më

(dd/mm/vvvv):

Nënshkruar:

(Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërisht)

Vendi:

Data: (dd/mm/vvvv)

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

MIRATIMI PASI ËSHTË KRYER INSPEKTIMI PËR RINOVIM DHE ZBATOHET RREGULLORJA 11.7*

* Kjo faqe miratimi pas inspektimit do të riprodhohet dhe do t'i bashkëlidhet certifikatës, siç çmohet e nevojshme nga Administrata.

Anija është në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës dhe kjo certifikatë, në përputhje me rregulloren 11.7 të shtojcës së Konventës, do të pranohet si e vlefshme deri më (dd/mm/vvvv):

Nënshkruar:
(Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërish)

Vendi:

Data: (dd/mm/vvvv)
(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

MIRATIMI PËR ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË CERTIFIKATËS DERI NË MBËRRITJE
NË PORTIN E INSPEKTIMIT OSE NË PERIUdhËN SHITESË PËR
KRYERJEN E PAGESËS, KU ZBATOHET RREGULLORJA 11.8 OSE 11.9*

Kjo certifikatë, në përputhje me rregulloren 11.8 ose 11.9** të shtojcës së Konventës, do të pranohet si e vlefshme deri më (dd/mm/vvvv):

Nënshkruar:
(Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërish)

Vendi:

Data: (dd/mm/vvvv)
(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

MIRATIM PËR INSPEKTIM SHITESË*

Gjatë një inspektimi shtesë në përputhje me rregulloren 10 të shtojcës së Konventës, u konstatua se anija ishte në përputhje me dispozitat përkatëse të Konventës.

Nënshkruar:
(Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërish)

Vendi:

Data: (dd/mm/vvvv)
(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

SHTOJCA 4
FORMULARI I CERTIFIKATËS NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË PËR RICIKLIM
CERTIFIKATA NDËRKOMBËTARE E GATISHMËRISË PËR RICIKLIM

* Kjo faqe miratimi pas inspektimit do të riprodhohet dhe do t'i bashkëlidhet certifikatës, siç çmohet e nevojshme nga Administrata.

** Mund të fshihet, sipas rastit.

(Shënim. Kjo certifikatë do të plotësohet nga inventari i materialeve të rrezikshme dhe Plani i Riciklimit të Anijeve)

(Vula zyrtare) (Shteti)

Lëshuar sipas dispozitave të Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009 (në vijim e referuar si “Konventa”) nën autoritetin e qeverisë së

.....
(Emri i shtetit)

nga

(Përcaktimi i plotë i personit ose organizatës së autorizuar sipas dispozitave të Konventës)

Të dhënat e anijes

| | |
|--|--|
| Emri i anijes | |
| Numri ose shkronjat dalluese | |
| Porti i regjistrimit | |
| Tonazhi bruto | |
| Numri IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare) | |
| Emri dhe adresa e pronarit të anijes | |
| Numri IMO i identifikimit të pronarit të regjistruar | |
| Numri IMO i identifikimit të shoqërisë | |
| Data e ndërtimit | |

Të dhënat e objektit/ve të riciklimit të anijeve

| | |
|---|--|
| Emri i objektit të riciklimit të anijeve | |
| Numri dallues i identifikimit të shoqërisë së riciklimit | |
| Adresa e plotë | |
| Data e skadimit të DASR (Dokumenti i autorizimit për të kryer riciklimin e anijeve) | |

*Ky numër bazohet në dokumentin e autorizimit për të kryer riciklimin e anijeve (DASR).

Të dhënat e inventarit të materialeve të rrezikshme

Numri i identifikimit/verifikimit të inventarit të materialeve të rrezikshme:

Shënim. Inventari i materialeve të rrezikshme, siç kërkohet nga rregullorja 5 e shtojcës së Konventës, është pjesë thelbësore e certifikatës ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim dhe duhet t'i bashkëlidhet gjithmonë asaj. Inventari i materialeve të rrezikshme duhet të përpilohet në bazë të formatit standard të treguar në udhëzimet e dhëna nga organizata.

Të dhënat e Planit të Riciklimit të Anijeve

Numri i identifikimit/verifikimit të planit të riciklimit të anijes:

Shënim: Plani i Riciklimit të Anijeve, siç kërkohet nga rregullorja 9 e shtojcës së Konventës, është pjesë thelbësore e certifikatës ndërkombëtare të gatishmërisë për riciklim dhe duhet t'i bashkëlidhet gjithmonë asaj.

VËRTETOHET SE:

1 anija është kontrolluar në përputhje me rregulloren 10 të shtojcës së Konventës;

2 anija ka një inventar të vlefshëm të materialeve të rrezikshme në përputhje me rregulloren 5 të shtojcës së Konventës;

3 Plani i Riciklimit të Anijeve, siç kërkohet nga rregullorja 9, pasqyron siç duhet informacionin e përfshirë në inventarin e materialeve të rrezikshme siç kërkohet nga rregullorja 5.4 dhe përmban informacion në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e “I sigurt për hyrjen” dhe kushtet e punës të cilat lidhen me nxehësinë.

4 Objekti ku do të riciklohet anija ka një autorizim të vlefshëm në përputhje me Konventën.

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më.....(dd/mm/vvvv)

(Data)

Lëshuar në

(Vendi i lëshimit të certifikatës)

(dd/mm/vvvv)

(Data e lëshimit) (Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërisht i cili lëshon certifikatën)

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

MIRATIMI PËR ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË CERTIFIKATËS DERI NË MBËRRITJE NË PORTIN E OBJEKTIT TË RICIKLIMIT TË ANIJEVE PËR PERIUdhËN SHITESË PËR KRYERJEN E PAGESËS, KU ZBATOHET RREGULLORJA 14.5*

Kjo certifikatë, në përputhje me rregulloren 14.5 të shtojcës së Konventës, do të pranohet si e vlefshme për një udhëtim të vetëm nga një pikë në tjetrën

nga porti i:

në portin e:

Nënshkruar:

(Nënshkrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërisht)

Vendi:

Data: (dd/mm/vvvv)

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

SHTOJCA 5

FORMULARI I AUTORIZIMIT TË OBJEKTEVE TË RICIKLIMIT TË ANIJEVE

Dokumenti i autorizimit për kryerjen e riciklimit të anijeve (DASR) në përputhje me kërkesat e Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009

Lëshuar sipas dispozitave të Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009 (në vijim e referuar si “Konventa”) nën autoritetin e qeverisë së

.....

(Emri i shtetit)

nga

(Përcaktimi i plotë i personit ose organizatës së autorizuar sipas dispozitave të Konventës)

* Kjo faqe miratimi pas inspektimit do të riprodhohet dhe do t'i bashkëlidhet certifikatës, siç çmohet e nevojshme nga Administrata.

| | |
|---|--|
| Emri i objektit të riciklimit të anijeve | |
| Numri dallues i identifikimit të shoqërisë së riciklimit | |
| Adresa e plotë e objektit të riciklimit të anijeve | |
| Personi kryesor i kontaktit | |
| Numri i telefonit | |
| Adresa e e-mailit | |
| Emri, adresa dhe informacioni i kontaktit të shoqërisë së pronësisë | |
| Gjuha/ët e punës | |

Vërtetohet se objekti i riciklimit të anijeve ka zbatuar sisteme, procedura dhe teknika menaxhimi në përputhje me kapitujt 3 dhe 4 të shtojcës së Konventës.

Ky autorizim është i vlefshëm deri më dhe i nënshtrohet kufizimeve të identifikuar në shtojcën bashkëlidhur.

Ky autorizim i nënshtrohet ndryshimit, pezullimit, tërheqjes ose rinovimit periodik në përputhje me rregulloren 16 të shtojcës së Konventës.

Lëshuar në

(Vendi i lëshimit të certifikatës)

(dd/mm/vvvv)

(Data e lëshimit) (Nënskrimi i nëpunësit të autorizuar ligjërisht i cili lëshon certifikatën)

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

SHTOJCË E DOKUMENTIT TË AUTORIZIMIT PËR TË KRYER RICIKLIMIN E ANIJEVE (DASR) NË PËRPUTHJE ME KONVENTËN NDËRKOMBËTARE TË HONG-KONGUT PËR RICIKLIMIN E SIGURT DHE MJEDISOR TË ANIJEVE, 2009

Shënime

1. Ky regjistër do t'i bashkëlidhet përgjithmonë DASR-së. DASR do të jetë i disponueshëm në objektin e riciklimit të anijeve në çdo kohë.

2. Të gjitha procedurat, planet dhe dokumentet e tjera të hartuara nga objekti i riciklimit të anijeve dhe të kërkuara sipas kushteve për të cilat është lëshuar DASR, do të jenë të disponueshme në gjuhën e punës të objektit të riciklimit të anijeve dhe në anglisht, frëngjisht ose spanjisht.

3. Autorizimi i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në këtë shtojcë.

1. KUSHTE TË PËRGJITHSHME

1.1 Kërkesat e Konventës

Objekti i riciklimit të anijeve plotëson kërkesat që ai të projektohet, ndërtohet dhe të funksionojë në mënyrë të sigurt për mjedisin në përputhje me Konventën, duke përfshirë përmbushjen e kërkesave përkatëse të:

Rregullores 16 – Autorizimi i objekteve të riciklimit të anijeve

Rregullores 17 – Kërkesa të përgjithshme

Rregullores 18 – Plani i objektit të riciklimit të anijeve

Rregullores 19 – Parandalimi i efekteve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin

Rregullores 20 – Menaxhimi i sigurt, për mjedisin, i materialeve të rrezikshme

Rregullores 21 – Gatishmëria dhe reagimi ndaj emergjencave

Rregullores 22 – Siguria dhe trajnimi i punëtorëve

Rregullores 23 – Raportimi i incidenteve, aksidenteve, sëmundjeve profesionale dhe efekteve kronike

Rregullores 24 – Kërkesat fillestare për njoftim dhe raportim

Rregullores 25 – Raportimi pas përfundimit

Këto kërkesa vendosen për objektin të riciklimit të anijeve me anë të

.....
(Identifikoni lejen, licencën, autorizimin, standardet ligjore ose mekanizmin tjetër që zbatohet)

Numri i identifikimit/verifikimit të planit të objektit të riciklimit të anijeve:

1.2 Pranimi i anijeve

Për anijet për të cilat zbatohet Konventa dhe anijet që trajtohen në mënyrë të ngjashme në përputhje me nenin 3.4 të Konventës, objekti i riciklimit të anijeve mund të pranojë vetëm një anije për riciklim në përputhje me rregulloren 17 të aneksit të Konventës.

1.3 Kushtet për “I sigurt për hyrje” dhe kushtet e punës të cilat lidhen me nxehtësinë

Objekti i riciklimit të anijeve duhet të krijojë, mirëmbajë dhe monitorojë kushtet e sigurta për “I sigurt për hyrjen” dhe kushtet e punës të cilat lidhen me nxehtësinë gjatë gjithë procesit të riciklimit të anijes.

1.4 Menaxhimi i materialeve të rrezikshme

Objekti i riciklimit të anijeve është projektuar, ndërtuar, operuar dhe kërkohet për të siguruar që i gjithë menaxhimi i materialeve të rrezikshme të jetë i sigurt dhe i favorshëm për mjedisin në përputhje me Konventën dhe me të gjitha rregulloret/kërkesat përkatëse lokale ose kombëtare.

1.5 Harta dhe vendndodhja ku kryhen proceset e riciklimit të anijeve

Bashkëlidhur gjendet një hartë e kufirit të objektit të riciklimit të anijeve dhe vendndodhjes ku kryhen proceset e riciklimit të anijeve brenda tij.

2. KAPACITETI I OBJEKTIT TË RICIKLIMIT TË ANIJEVE

2.1 Madhësia e anijeve

Objekti i riciklimit të anijeve është i autorizuar të pranojë një anije për riciklim që i nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme në lidhje me madhësinë:

| Madhësia maksimale | | Kufizime të tjera |
|--------------------|--|-------------------|
| Gjatësia | | |
| Gjerësia | | |
| Pesha boshe | | |

2.2 Menaxhimi i sigurt, për mjedisin, i materialeve të rrezikshme

Objekti i riciklimit të anijeve është i autorizuar të pranojë për riciklim një anije që përmban materiale të rrezikshme siç specifikohet në tabelën e mëposhtme, duke iu nënshtuar kushteve të shënuara më poshtë:

| Materiali i rrezikshëm (*4) | Menaxhimi i materialeve të rrezikshme | | | Autorizim/kufizime |
|---------------------------------------|---------------------------------------|------------------|------------------------------|--------------------|
| | Heqje PO/JO (*2) | Ruajtje PO/JO | Përpunimi (*1) PO/JO (*3) | |
| Asbesti | | | | |
| Substancat që shkatërrojnë ozonin | | | | |
| Bifenilet e poliklorinuara (PCB) | | | | |
| Përbërjet dhe sistemet kundër ndotjes | | | | |

| | | | | |
|---|--|--|--|--|
| Kadmiumi dhe përbërjet e kadmiumit | | | | |
| Kromi gjashtëvalent dhe përbërjet e kromit gjashtëvalent | | | | |
| Plumbi dhe përbërjet e plumbit | | | | |
| Merkuri dhe përbërjet e merkurit | | | | |
| Bifenil i polibrominuar (PBB) | | | | |
| Eteret difenil i polibrominuar (PBDE) | | | | |
| Naftalenet e poliklorinuara (më shumë se 3 atome klori) | | | | |
| Substancat radioaktive | | | | |
| Disa parafina të klorinuara me zinxhir të shkurtër (alkane, C10-C13, kloro) | | | | |
| Lëngjet, mbetjet dhe sedimentet e rrezikshme | | | | |
| Bojëra dhe veshje që marrin flakë shpejt ose që shkaktojnë çlirime toksike | | | | |
| Materiale të tjera të rrezikshme që nuk janë renditur më sipër dhe që nuk janë pjesë e strukturës së anijes (specifikoni) | | | | |

Shënime. *1 Përpunimi nënkupton përpunimin e materialeve të rrezikshme në objektin e riciklimit të anijeve, si p.sh.

- a) djegia e materialeve të rrezikshme;
- b) rikuperimi i materialeve të rrezikshme; dhe
- c. trajtimi i mbetjeve vajore.

*2. Nëse Po, specifikoni në Planin e Objektivit të Riciklimit të Anijeve personelin përgjegjës të autorizuar për të kryer heqjen, me numrin e certifikatës ose informacione të tjera përkatëse.

*3. Nëse Jo, përshkruani në Planin e Riciklimit të Anijes se ku do të përpunohen/hidhen materialet e rrezikshme.

*4. Këto materiale të rrezikshme janë të specifikuara në shtojcat 1 dhe 2 dhe rregulloren 20 të Konventës.

SHTOJCA 6

FORMULARI I RAPORTIT TË FILLIMIT TË PLANIFIKUAR TË RICIKLIMIT TË ANIJES

.....
(Emri i objektit të riciklimit të anijeve)

që ndodhet në
(Adresa e plotë e objektit të riciklimit të anijeve)

Autorizuar sipas kërkesave të Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009 (në vijim e referuar si “Konventa”) për të kryer riciklimin e anijes nën autoritetin e qeverisë së:

.....
(Emri i shtetit)

siç përcaktohet në dokumentin e autorizimit për të kryer riciklimin e anijes, të lëshuar në

.....
(Vendi i autorizimit)

nga

(Përcaktimi i plotë i autoritetit kompetent sipas Konventës)

më (dd/mm/vvvv)

(Data e lëshimit)

Raporton se objekti i riciklimit të anijeve është gati nga çdo aspekt për të filluar riciklimin e anijes

(Numri IMO)

Certifikata ndërkombëtare e gatishmërisë për riciklim e lëshuar sipas dispozitave të Konventës nën autoritetin e qeverisë së

.....
(Emri i shtetit)

nga

(Përcaktimi i plotë i personit ose organizatës së autorizuar sipas dispozitave të Konventës)

më (dd/mm/vvvv)

(Data e lëshimit)

është bashkëlidhur

Nënshkruar

...

SHTOJCA 7

FORMULARI I DEKLARATËS PËR PËRFUNDIMIN E RICIKLIMIT TË ANIJES DEKLARATA PËR PËRFUNDIMIN E RICIKLIMIT TË ANIJES

Ky dokument është një deklaratë për përfundimin e riciklimit të anijeve për

.....
(Emri i anijes në momentin e marrjes për riciklim/ në kohën e çregjistrimit)

Të dhënat e anijes që u mor për riciklim

| | |
|--|--|
| Numri ose shkronjat dalluese | |
| Porti i regjistrimit | |
| Tonazhi bruto | |
| Numri IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare) | |
| Emri dhe adresa e pronarit të anijes | |
| Numri IMO i identifikimit të pronarit të regjistruar | |
| Numri IMO i identifikimit të shoqërisë | |
| Data e ndërtimit | |

VËRTETOHET SE:

Anija është ricikluar në përputhje me Planin e Riciklimit të Anijeve si pjesë e Konventës Ndërkombëtare të Hong-Kongut për Riciklimin e Sigurt dhe Mjedisor të Anijeve, 2009 (në vijim e referuar si “Konventa”) në:

.....
(Emri dhe vendndodhja e objektit të riciklimit të anijeve)

dhe riciklimi i anijes përfundoi sipas kërkesave të Konventës, më:

(dd/mm/vvvv).....
(Data e përfundimit)

Lëshuar më
(Vendi i lëshimit të deklaratës për përfundimin)

(dd/mm/vvvv).....
(Data e lëshimit) (Nënshkrimi i pronarit të objektit të riciklimit të anijëve ose i një përfaqësuesi që vepron në emër të pronarit)